



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
E JURIDIKSIONIT TE PERGJITHSHEM
KORÇË

Nr. Akti 838

Datë 19.10.2023

Datë regjistrimi 31.01.2023

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar: Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq
Per te paditurin: Apostol (Ngjallim) Baçi, banues në fshatin Vreshtas, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq.

Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Korçë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtar **Seladin Pysqyli**, asistuar nga sekretare Eriselda Elmazaj, sot më datë **19.10.2023**, përfundoi gjykimin e çështjes civile me **nr. Vendimi 802**, me palë dhe objekt:

PADITËSE: **Almira Baçi** (mbiemri paramartesor Gala), e bija e Myrteza dhe Xhezmie, e datëlindjes 26.07.1976, lindur e banuese në fshatin Bregas, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq, prezent në seancë pajtimore dhe më pas përfaqshuar nga avokate Entela Dvorani antare e Dhomës Vendore të Avokatëve Korçë.

I PADITUR: **Apostol Baçi** (me vendim nr.3, datë 19.12.1996 të ish Këshillit të Komunës Vreshtas, ka ndruar emrin nga Ngjallim në Apostol), i biri i Gani dhe Vezire, i datëlindjes 25.09.1973, lindur e banues në fshatin Vreshtas, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq, aktualisht me qëndrim në Greqi, në mungesë.

OBJEKTI: Zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur midis palëve më datë 21.10.1997 pa u shprehur gjykata në lidhje me fajësinë dhe kthimin e mbiemrit paramartesor paditëses.

Baza ligjore: Nenet 129 e 132 e vijues të K.Familjes.

Në përfundim të gjyimit të zhvilluar në prani të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, përfaqshuesja e paditëses kërkoi zgjidhjen e martesës pa u shprehur gjykata në lidhje me fajësinë dhe kthimin e mbiemrit paramartesor paditëses. Në lidhje me shpenzimet gjyqësore kërkoi të lihen siç janë kryer, në ngarkim të paditëses.

Gjykata, pasi dëgjoi palën paditëse dhe analizoi provat e marra në gjykim, bazuar në nenet 129 e 132 e vijues të K.Familjes,

VENDOSI:

1-Zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur më datë 21.10.1997 midis paditëses Almira Myrteza Baçi dhe të paditurit Apostol (Ngjallim) Gani Baçi.

2-Me zgjidhjen e martesës paditësja Almira merr mbiemrin paramartesor, nga Baçi në Gala.

3-Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë kryer.

4-Urdhërohet sekretaria e gjykatës që, pasi vendimi të marrë formë të prerë, ti dërgojë një kopje të tij Z.Gj.Civile Vreshtas për të bërë ndryshimet përkatëse në regjistër.

Nr. 55 P. 8/2023
Dt. 1.11.2023
A. Ureshtas
ST 101 P
Dt 30.10.2023

5-Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

-U shpall në Korçë, sot më datë 19.10.2023.

SEKRETARE
Eriselda ELMAZAJ



Shënim: Kjo shpallje do të qëndroje e afishuar në vendet e mësipërme minimalisht 20 (njëzet ditë) nga data e afishimit.

Shpallja do t'iu dërgohet në dy kopje, njëra prej të cilave duhet të përcillet në gjykatë, menjëherë pas afishimit.

Shpallja u publikua sot në datë _____.

Për Njesinë Administrative _____

(emër, mbiemër, firmë)